



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË

Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve dhe Shoqërive të Vogla dhe të Mesme

U R D H E R

Nr./51 Date 15-5-2003

PER

**TRANSFORMIMIN E NDERMARRJES SHTETERORE “UJESJELLES FSHAT”
KORÇE. NE SHOQERI ANONIME “UJESJELLES FSHAT ” SH.A. KORÇE**

Drejtuar: Shoqerise ne formim e siper “Ujesjelles Fshat” Korçe

Duke marre parasysh percaktimin e kapitalit themeltar te shoqerise qe do te krijohet nga transformimi i Ndermarrjes “Ujesjelles Fshat” Korçe nga ekspert kontabel te autorizuar sipas urdherit nr. 130 date 4/10/2002,

KONSTATOVA

Se ne baze te nenit 1 te Ligjit Nr. 8885, date 22.04 2002 “Per disa ndryshime ne ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 “Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare”, ndryshuar me Ligjin Nr.8067, date 15.02.1992; Nr.8099, date 28.03.1996; Nr. 8158, date 1.09.1997; Nr. 8482, date 10.05.1999, dhe me Dekretet Nr. 1195,date 14.08.1995 dhe Nr. 1615, date 20.09.1996 duhet te krijohen aktet e themelimit te shoqerise,

Persa me siper, ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise,

URDHEROJ:

1. Transformimin e Ndermarrjes “Ujesjelles Fshat” Korçe ne shoqeri te formes anonime “Ujesjelles Fshat” SH.A Korçe.
2. Anetar te keshillit te pare mbikqyres emerohen:
Zj. Diana Jahja
Z. Andrea Janko
Z. Agron Agalliu

3. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla e te Mesme dhe Drejtoria Juridike te ndjeke zbatimin e ketij urdheri .

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

Arben MALI

MINISTËR
TIRANE

